



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë më, 18.02.2018, ora 11.00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat”, të ndryshuar”” *(Nismë e Këshillit të Ministrave)*
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat”, të ndryshuar””
(Nismë e deputetit Petrit Vasili)

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Anastas Angjeli, Antoneta Dhima, Ervin Bushati, Evis Kushi, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Reme Lala, Vullnet Sinaj, Ismet Beqiraj, Pjerin Ndreu dhe Edmond Haxhinasto.

Mungojnë:

Blerina Gjylameti, Senida Mesi, Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Anila Denaj – Ministre e Ekonomisë dhe Financave

Erjon Luçi – Zëvendësministër i Ekonomisë dhe Financave

Rovena Beqiraj – Drejtoreshë në Ministrinë për Ekonominë dhe Financat

Alda Klosi – Drejtoreshë në Ministrinë për Ekonominë dhe Financat

Gentian Opre – Drejtor në Ministrinë për Ekonominë dhe Financat

Majlinda Demko – Këshilltare në Ministrinë për Ekonominë dhe Financat

Petrit Vasili – Deputet

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Të nderuar kolegë deputetë, fillojmë mbledhjen e Komisionit për Ekonominë dhe Financat, duke nisur me miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar. Ka komente?

(Deputeti Haxhinasto ndërhyrje pa mikrofon.)

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi shqyrtimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat”, të ndryshuar”, si nismë e Këshillit të Ministrave, ndërsa si pikë të tretë kemi shqyrtimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat”, të ndryshuar”, si nismë e deputetit Petrit Vasili.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta mbaroj dhe jua jap fjalën.

Të pranishëm në komision kemi ministren e Ekonomisë dhe Financave, zonja Anila Denaj, e cila shoqërohet nga stafi i saj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Haxhinasto.

Edmond Haxhinasto – Faleminderit, zoti kryetar!

Nga propozuesi për pikën e tretë të rendit të ditës jam informuar se është bërë një kërkesë pranë jush për ta shtyrë diskutimin, pasi ai e ka të pamundur të jetë sot për ta paraqitur.

Duke u nisur edhe nga fakti që projekti është paraqitur që në shkurt të vitit 2016, mendoj se duhej të ishte pranuar një shtyrje e tillë e diskutimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si draft është paraqitur prej tre vjetësh, kështu që se u shty edhe tri ditë nuk besoj se ka ndonjë... Do të ishte treguar pak më racionalitet dhe konstruktivitet në shtyrjen e diskutimit, flas gjithnjë për pikën e tretë të rendit të ditës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – E qartë.

Nuk është e thënë që të shtyhej, por përderisa zoti Vasili ka një arsye madhore, sipas asaj që ka kërkuar, ne do të vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës, me diskutimin për ligjin dhe ndryshimet ligjore, pastaj në një moment të dytë ne mund të diskutojmë edhe nismën e zotit Vasili.

Ajo që unë mund t'ju theksoj, zoti Haxhinasto...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Meqenëse edhe zoti Vasili nuk është prezent, ndryshimet janë dorëzuar në Kuvend...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

U lutem përfaqësuesve të medias të mbajnë qetësi, se nuk bëhet mbledhja për ta!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk mundem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Meqenëse ndryshimet janë dorëzuar në Kuvend nga Këshilli i Ministrave që në dhjetor dhe, siç e thatë, nisma e zotit Vasili ka disa vite që ripërsëritet, në garanci të plotë ju them, zoti Haxhinasto, meqenëse edhe vetë kam qenë një nga hartuesit e ndryshimeve, që ajo që sjell qeveria i tejkalon të gjitha, le të themi, meraket që mund të ketë parlamenti dhe garanton një kontroll shumë të fortë, mbi të gjitha, të Ministrisë së Financave, si autoriteti gardian fiskal për çdo nismë që vjen në formën e partneritetit publik-privat.

Para se t'ia jap fjalën ministres, edhe për arsye...

Edmond Haxhinasto – Për procedurë...

Arben Ahmetaj – Ja, ta mbaroj.

Edmond Haxhinasto – Domethënë, ju vendosët që ta shtyni diskutimin sot.

Arben Ahmetaj – Patjetër që po.

Para se t'ia jap fjalën ministres, meqenëse në akord me komisionin edhe për arsye se në pozicionin që mbaja në dhjetor, atë të ministrit të Financave, e kam hartuar së bashku me stafin dhe e kam kaluar në qeveri ligjin, po e bëj vetë relatorin, me lejen e komisionit, për t'ia dhënë fjalën pastaj ministres, që të bëjë një prezantim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Themeli i ndryshimeve është heqja e propozimeve të pakërkua në një sërë sektorësh. Ajo që dua të theksoj për publikun është që të gjitha propozimet e pakërkua kanë qenë pjesë e ligjit që në momentin e parë, pra të ligjit organik fillestar, të hartuar dhe të kaluar nga qeveria e Partisë Demokratike dikur. Pra, është hera e parë që për sektorë, siç është infrastruktura dhe jo vetëm, hiqen propozimet e pakërkua. Kjo është një nismë e qeverisë

dhe e kësaj maxhorance edhe për një arsye krejt të thjeshtë, sepse tashmë administrata është në gjendje që të hartojë, aq më tepër edhe me strukturën e re ligjore, që shpresoj ta kalojmë javën që vjen në parlament, administrata është më e përgatitur për të bërë propozime të kërkuara.

Siç e theksova, referuar rekomandimeve të institucioneve të ndryshme ndërkombëtare, si: Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, SIGMA dhe OECD-ja, është propozuar kufizimi i të drejtës së identifikimit dhe zhvillimit të propozimeve të projekteve të koncesioneve apo partneritetit publik-privat nëpërmjet propozimeve të pakërkuara nga sektori privat.

Tashmë, duke qenë se Shqipëria e ka krijuar një eksperiencë në fushën e koncesioneve që prej vitit 2004, duke përfituar edhe nga ekspertiza e sjellë nga sektori privat në zhvillimin e studimeve të fizibilitetit për projektet e koncesionit të partneritetit publik-privat të zhvilluara deri tani, por edhe nga partnerët ndërkombëtarë, është momenti që të hiqet dorë për sektorin e infrastrukturës, siç e thashë edhe më lart, nga propozimet e pakërkuara.

Konkretisht, me anën të këtij projektligji propozohet të theksohet që nga data 1 korrik i vitit 2019, të mos lejohen më propozime të pakërkuara në disa sektorë, kryesisht në atë të infrastrukturës, por të ngelen në traditën e propozimeve të pakërkuara ofrimi i shërbimi në porte, aeroporte (pra ndërtimi dhe ofrimi i shërbimeve); prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike (HEC-et dhe TEC-et), si dhe energjia për ngrohjen dhe shpërndarjen e gazit natyror.

Duke qenë se sektori i energjisë, portet dhe aeroportet mbeten sektorë strategjikë, është lejuar mundësia e propozimit të pakërkuar nga sektori privat, por duke përjashtuar përfitimin e pikëve bonus për propozimin e pakërkuar, duke ardhur kështu te pika e dytë e draftligjit që propozon qeveria, ku hiqet bonusi për propozimet e pakërkuara. Sigurisht, kjo vjen në vazhden e rritjes së transparencës dhe trajtimit të barabartë.

Edhe një herë, me anë të këtij projektligji, pas datës 1 korrik të vitit 2019, do të hiqet sistemi i shpërblimit të propozuesve të pakërkuar me pikë bonusi.

Siç e thashë më lart, një nga elementet e ligjit është forcimi i rolit të Ministrisë përgjegjëse të Financave. Duke qenë se projektet e koncesionit, pra të partneritetit publik-privat, janë komplekse, afatgjata dhe implikojnë një sërë risqesh, si dhe detyrimesh kontigjente të konsiderueshme për buxhetin e shtetit, është e nevojshme dhe e domosdoshme që të gjitha këto projekte, si ato me dhe pa mbështetje financiare, të paraqiten paraprakisht në

Ministrinë përgjegjëse për Financat për vlerësim dhe miratim në këndvështrimin e implikimeve fiskale dhe buxhetore.

Një parashikim tjetër, që vlerësohet shumë i rëndësishëm, është që para nënshkrimit të kontratës përfundimtare të koncesionit apo të partneritetit publik-privat kjo kontratë të paraqitet sërish për vlerësim pranë Ministrisë së Financave. Pra, kontrata të mos firmoset pa dhënë okejin Ministria e Financave për të gjithë vlerësimin e risqeve. Në të njëjtën frymë, kjo do të kërkojë edhe forcimin e njësive të risqeve brenda strukturës së buxhetit.

Në këtë aspekt i sugjeroj ministres të kërkojë rritjen e numrit të punonjësve dhe trajnime specifike, në mënyrë që grupi ose njësia, entiteti, të ketë mundësi të bëjë një vlerësim të gjerë dhe të thellë të çdo kontrate, si dhe forcimin e Drejtorisë së Koncesioneve, që praktikisht filtron nga ana fiskale dhe jo vetëm të gjitha koncesionet, apo që do të filtrojë të gjitha koncesionet që do të kalojnë nga data 1 korrik ose nga momenti që ky ligj kalon në parlament.

Një pikë tjetër e rëndësishme ka të bëjë me ngritjen e Komitetit të Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit. Siç e thashë, qeveria, administrata, merr përsipër hartimin e projekteve për të dalë me oferta të kërkuara. Me qëllim rritjen e cilësisë së studimit të fizibilitetit për projektet e koncesionit apo të partneritetit publik-privat, në projektligj është parashikuar edhe krijimi i Komitetit të Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit, i cili do të jetë organ kolegjal, me objekt kryesor të veprimtarisë së tij përzgjedhjen e projekteve të koncesionit, të cilat do të asistohen me ekspertizë të specializuar për hartimin e studimeve të fizibilitetit dhe/ose oponencën e saj.

Duke marrë shkas se me anën e këtij projektligji kemi kufizuar, pra do të kufizojmë, mundësitë e zhvillimit të projekteve të koncesionit nga sektori privat, pra ofertën e pakërkuar, sigurisht që ekspertiza e administratës është tejet e rëndësishme, por, mbi të gjitha, ka nevojë për një sens prioritizimi. Ndaj, Komiteti i Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit ose partneritetit publik-privat është në vazhden e kësaj logjike.

Përpara se t'ia jap fjalën ministres për rekord publik, dua t'ju informoj se në Republikën e Shqipërisë deri sot janë bërë rreth 217 koncesione, nga të cilat 183 janë bërë para vitit 2013, ku të gjitha ose, më mirë të themi, 99% e tyre janë bërë në formën e ofertës së pakërkuar dhe shumë prej tyre, siç janë: pullat fiskale, skanimi, markimi apo edhe rruga konsekuencë e hidrocentralit të Devollit janë bërë me kosto të drejtpërdrejtë buxhetore dhe me kosto të rëndë për sektorin privat. Për rastin e skanimit, siç e mbani mend, qeveria “Rama” u detyrua ta rinegocionte kontratën për shkak të ngarkesës së rëndë mbi

sipërmarrjen, ku shkonte 40 euro për deklaratën. Qeveria u detyrua ta rinegocionte kontratën duke ulur koston nga 40 euro në 22 euro dhe ta përjashtonte të gjithë industrinë fason nga pagesa e deklaratës, duke ngarkuar 1,9 miliardë lekë në vitin 2018 ngarkesë për tatimpaguesit vetëm për këtë koncesion.

Ndërkohë, siç e theksova, edhe nga koncesionet në hidroenergji, për shkak të formatit dhe të garantimit të çmimit shumë më të lartë se tregu, OSHEE-ja, pra Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, besoj se llogaritë do të rifreskohen, gjatë nëntëmujorit të vitit 2018 ka pasur një goditje në bilanc prej 39 milionë eurosh, të cilat nuk i numëron asnjëri, por janë goditje të drejtpërdrejta në buxhetin e shtetit dhe tek tatimpaguesit.

Praktikisht, me ndryshimet ligjore rritet niveli i transparencës, ofrohet një kontroll më i lartë nga autoriteti i Ministrisë së Financave dhe besoj që edhe administrata, për sa u përket projekteve të infrastrukturës, do të ketë mundësi të vijë me oferta të kërkuara.

Duke ju falënderuar për vëmendjen, fjalën e ka ministrja e Financave, zonja Anila Denaj.

(Deputeti Haxhinasto kërkon fjalën pa mikrofon.)

Patjetër, po.

Edmond Haxhinasto – Faleminderit, zoti kryetar!

Arben Ahmetaj – Besoj se e merrni fjalën për procedurë, apo jo?

Edmond Haxhinasto – Po, për procedurë.

Dua të sjell në vëmendjen tuaj që ju tashmë jeni kryetar i Komisionit për Ekonominë dhe Financat dhe përfaqësoni legjislativin shqiptar, pra nuk jeni përfaqësues i ekzekutivit. Këto janë dy pushtete të ndryshme dhe është e shkruar në ligjet e vendit se ju duhet të bëni oponencë ndaj çdo materiali legjislativ që vjen për t’u trajtuar këtu. Unë e kuptoj që ju keni patjetër dëshirë për ta bërë këtë, sepse mund ta keni hartuar vetë ligjin, por do t’ju sillja në vëmendje që funksionojmë në pushtete të ndara.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Edmond Haxhinasto – Legjislativi është i ndarë nga ekzekutivi.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Haxhinasto, për kujtesën!

Edmond Haxhinasto – Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Maxhoranca është një, gjithsesi, por ju keni të drejtë.

Zonja Ministre, fjala është për ju.

Anila Denaj – Faleminderit, zoti kryetar i komisionit!

Të nderuar anëtarë të komisionit, më lejoni të jap disa shpjegime më të hollësishme në raport me projektligjin.

Synimi i projektaktit është të përmirësojë kuadrin ligjor, mënyrën e zbatimit të procedurave për dhënien e koncesioneve dhe partneritetit publik-privat, të rrisë kontrollin mbi angazhimet fiskale të marra përsipër nga autoritetet kontraktuale, nëpërmjet kontratave të koncesionit dhe partneritetit publik-privat, me qëllim minimizimin e impaktit fiskal në buxhetin e shtetit.

Duhet të theksojmë se në hartimin e këtij projektligji janë marrë në konsideratë rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare, si: Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, SIGMA dhe OECD-ja, të cilat kanë raportuar dhe monitoruar legjislacionin dhe procedurat e dhënies së koncesioneve dhe partneritetit publik-privat në vendin tonë.

Këto ndryshime vijnë në koherencë dhe në harmoni të plotë me ndryshimet e bëra më parë në ligjin organik nr. 9936 të vitit 2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar së fundi.

Disa nga risitë kryesore të këtij projektakti janë si më poshtë.

Së pari, heqja e propozimeve të pakërkuara në një sërë sektorësh. Kemi propozuar kufizimin e së drejtës së identifikimit dhe të zhvillimit të propozimit të projekteve të koncesionit dhe/ose partneritetit publik-privat, nëpërmjet propozimeve të pakërkuara nga sektori privat. Konkretisht, me anën e këtij projektligji është propozuar që nga data 1 korrik e vitit 2019 të lejohen propozimet e pakërkuara vetëm për realizimin e punimeve ose ofrimin e shërbimeve në porte, aeroporte, për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje dhe shpërndarjen e gazit natyror. Nuk do të jetë më e mundur të propozojnë nga sektori privat projekte koncesioni dhe/ose partneritet publik-privat në formën e propozimit të pakërkuar për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale me rëndësi të veçantë. Pas datës së lartpërmendur, këto projekte do të zhvillohen sipas procedurave dhe rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 125/2013 dhe jo më me procedurë të veçantë, siç trajtohen aktualisht.

Një pikë tjetër shumë e rëndësishme është heqja e bonusit për propozimet e pakërkuara. Me qëllim rritjen e transparencës dhe trajtimit të barabartë për të gjithë operatorët në procedurën e konkurrimit është hequr mekanizmi i shpërblimit me pikë bonus të operatorëve që paraqesin propozim të pakërkuar.

Për të nxitur sektorin privat dhe për të propozuar projekte të studiuara, duke përdorur kapacitetet dhe eksperiencën e tyre, është propozuar zëvendësimi i sistemit me pikë bonus me

atë të kompensimit me vlerë monetare të propozuesit të pakërkuar. Në rast se ky i fundit nuk shpallet fitues, gjithsesi, në çdo rast vlera e kompensimit nuk mund të jetë më e lartë se 1% e vlerës së investimit. Mekanizmi i propozuar i kompensimit nuk cenon konkurrencën dhe nuk avantazhon propozimin e pakërkuar.

Së treti, forcimi i rolit të Ministrisë përgjegjëse për Financat dhe Ekonominë. Qëllimi i këtij projektakti është përcaktimi i qartë i rolit dhe përgjegjësi të Ministrisë përgjegjëse për Financat në lidhje me vlerësimin, miratimin e të gjithë projekteve të koncesionit/partneritetit publik-privat dhe ecurinë e kontratave të koncesionit/partneritetit publik-privat nga pikëpamja e implikimeve fiskale, individuale apo në grup për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale.

Momentalisht, Ministria përgjegjëse për Financat nuk merr nga autoritetet kontraktuale dhe si rrjedhojë nuk shqyrton raporte për performancën e ecurisë së tyre pas nënshkrimit dhe pas fillimit të projekteve. Menaxhimi i riskut fiskal kërkon një vlerësim periodik të performancës së tyre. Në rastin e performancës së dobët të kontratave është e nevojshme marrja e masave të menjëhershme për minimizimin e kostove fiskale.

Ministria përgjegjëse për Financat duhet të jetë e informuar në lidhje me risqet e kontratave për t'i analizuar dhe minimizuar këto risqe fiskale dhe buxhetore.

Një parashikim, që vlerësohet shumë i rëndësishëm, është që përpara nënshkrimit të kontratës përfundimtare të koncesionit ose të partneritetit publik-privatë, kjo kontratë të paraqitet sërish për vlerësim pranë Ministrisë përgjegjëse për Financat. Çfarë ka ndodhur më përpara është që bëhej kalimi te Ministria e Financave për të marrë një opinion, pastaj në procesin e negociatave dhe negociimeve, nëse do të kishte ndryshime ato nuk vinin për informim te ministria përgjegjëse. Pra, në njëfarë mënyre, nuk kishte një përgjigje as nga Ministria e Financave për implikimet fiskale që mund të ekzistonin pas negociimeve. Me ndryshimet që vijnë kjo gjë eliminohet.

Gjithashtu, për të shmangur çdo ndryshim dhe çdo kosto shtesë, si rrjedhojë e vënies në zbatim të këtyre projekteve, është e domosdoshme që çdo ndryshim, si gjatë fazës së përgatitjes dhe çdo ndryshim pas, duhet të vijë për opinion dhe për vlerësim nga Ministria e Financave.

Së katërti, lidhur me Komitetin e Përzgjedhjes së Projekteve koncesionit/partneritetit publik-privat, me qëllim rritjen e cilësisë së studimeve të fizibilitetit për projektet e koncesionit/partneritetit publik-privat, në projektligj është parashikuar krijimi i Komitetit të

Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesioneve ose partneritet publik-privat, i cili do të jetë një organ kolegjal me objekt kryesor të veprimtarisë përzgjedhjen e projekteve të koncesioneve dhe PPP-ve, të cilat do të asistohen me ekspertizë të specializuar për hartimin e studimeve të fizibilitetit dhe/ose oponencën e tyre.

Duke marrë shkas se me anë të këtij projektligji janë kufizuar mundësitë e zhvillimit të projekteve të koncesionit/partneritetit publik-privat nga sektori privat, pra është kufizuar eksperiencia që vjen nga sektori privat, do të mundësohet që për këto projekte të veçanta autoritetet publike të asistojnë me ekspertizë të specializuar për të hartuar studimet ose për të bërë oponencë më cilësore. Pikërisht, ndryshimi i kuadrit institucional, i parashikuar në këtë projektligj, do të sjellë përgatitjen me cilësi të studimit të fizibilitetit, i cili përbën thelbin e rezultateve dhe suksesit të një projekti koncesioni/PPP-je, sikurse dhe mbështetjen me ekspertizë të specializuar për t'u bërë oponencë propozimeve të pakërkuara në sektorët ku do të lejohet paraqitja e propozimeve të pakërkuara.

Më lejoni të theksoj se transparenca do të jetë në fokus. Ajo është sot aktuale. Nëse do të shkoni te faqja zyrtare e internetit e ATRAKO-s, do të gjeni informacion për të gjitha kontratat koncesionare/PPP-të.

Mendojmë se pas këtij projektligji do të vendoset edhe analiza e informacionit të shtuar, që do të shoqërojë ndryshimet strukturore në ministri, sikurse u komentuan edhe pak më parë nga kryetari i komisionit.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Ka ndonjë koment? Po, zoti Haxhinasto.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndjesë, e keni pyetje, apo koment?

Edmond Haxhinasto – Sipas procedurës së komisionit duhen bërë pyetjet dhe pasi të mbarojnë pyetjet, bëhen komentet. Kështu që, do të kërkoja lejen tuaj që unë të vazhdoj me pyetjet për zonjën ministre.

Arben Ahmetaj – Patjetër, urdhëroni!

Edmond Haxhinasto – Faleminderit, zonja Ministre, për paraqitjen e relacionit!

Kam disa pyetje.

Zonja Ministre, për përgatitjen e këtij projektligji a keni bërë ndonjë vlerësim paraprak se si kanë ecur PPP-të dhe koncesionet e deritanishme? Cili është vlerësimi juaj për ecurinë e tyre?

Arben Ahmetaj – Sugjeroj t’i bëni të gjitha pyetjet dhe pastaj të përgjigjet ministrja, apo dëshironi të vijojmë me pyetje-përgjigje një nga një?

Edmond Haxhinasto – Kam frikë se mos humbim në përkthim.

Arben Ahmetaj – Nuk besoj, sepse stafi po mban shënime.

Edmond Haxhinasto – Do të jetë e saktë në përgjigje?

Arben Ahmetaj – Ministrja do të jetë shumë e saktë, jua garantoj.

Edmond Haxhinasto – Ju falënderoj!

Pyetja e dytë është: çfarë nuk ka funksionuar me koncesionet ose me PPP-të e sektorit të infrastrukturës rrugore që hiqen nga mundësia që ofron ky projektligj? Pse efekti është deri më 1 korrik? Çfarë përfaqëson data 1 korrik?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Thoni se deri më 1 korrik mund të paraqiten, ndërsa pas kësaj date jo. Çfarë do të thotë kjo datë?

Pyetja e tretë është: a do të jetë me koncesion rruga Tiranë – Durrës?

Pyetja e katërt. Në gjykimin tim, janë katër probleme kryesore, që kuadri ligjor nuk i ka zgjidhur deri sot.

Së pari, nuk ka garantuar dot një kosto më të ulët të parasë që investohet, krahasuar me koston e parasë që mund të marrë qeveria, sepse patjetër që qeveria merr para me kosto më të ulët se sa një privat.

Së dyti, është problemi i konkurrencës së hapur, pra i mundësive për të ofruar për të njëjtin projekt kosto më të ulët, si rezultat i konkurrimit të hapur.

Së treti, garancia për qëndrueshmërinë e investimit, përtej kohës së koncesionit ose të partneritetit publik-privat. Ne e kemi limitin deri në 35 vjet, por kush na garanton që kur kjo t’i kthehet, meqenëse përgjithësisht janë BOT (*build–operate–transfer*), kjo do të ketë një kosto me vlerë edhe për publikun më pas kur t’i kalojë sektorit publik.

Në fakt, ka edhe një shqetësim tejet të qenësishëm, por që nuk përmendet, që ka të bëjë me përputhshmërinë e propozimeve të pakërkuara deri sot me prioritetet kombëtare. Dëshiroj të sjell në vëmendjen tuaj që, si detyrim i Procesit të Berlinit, qeveria e ka bërë një ushtrim: ka përcaktuar listën e prioritetëve kombëtare, por, me keqardhje, koncesionet (edhe PPP-të gjithmonë) që janë propozuar kanë pak lidhje me listën e prioritetëve kombëtare. Pra, shtrohet pyetja: si i trajton ligji që ju sillni sot këto problematika, si i zgjidh këto probleme? Kjo ishte pyetja e katërt.

Pyetja e pestë. Zonja Ministre, ju thatë që për hartimin e këtij ligji janë marrë parasysh edhe rekomandimet e FMN-së dhe të organizatave të tjera. A mund të na thoni cilin rekomandim specifikisht keni marrë parasysh? A keni marrë parasysh edhe llogaritjen si borxh të detyrimeve të pagesave vjetore për PPP-të?

Pyetja e parafundit ka të bëjë me atë që ju thatë, se me anën e këtij projektligji rrisni kompetencat e Ministrisë së Financave. Në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës thuhet: “Ministri drejton nën përgjegjësinë e tij veprimtarinë që ka në kompetencë”, pra kompetenca e infrastrukturës është nën ministrin e Infrastrukturës. Si mundet që ministri i Financave të marrë kompetenca, të cilat, me Kushtetutë, i takojnë një ministri dhe një ministrie tjetër?

Pyetja e fundit, meqenëse ju e përmendët të fundit, ka të bëjë me çështjen e studimit të fizibilitetit, që, në qoftë se e kuptova mirë nga sa u paraqit, në fakt, ishte edhe në relacion, thuhet: “do të financohet nga ana e sektorit publik”, pra me paratë e buxhetit. Këto do të jenë propozime të kërkuara dhe do të paraqiten nga ana e ministrisë, meqenëse do të përgatitet studimi i fizibilitetit? Sepse janë investime, ato janë para.

Këto janë pyetjet që kam.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Haxhinasto!

Zonja Ministre, fjala është për ju.

Anila Denaj – Faleminderit, zoti Haxhinasto!

Faleminderit, zoti kryetar!

Kërkoj leje që në momente të caktuara për disa përgjigje të kërkoj edhe ndihmën e kolegëve të mi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Patjetër.

Anila Denaj – Së pari, në raport me koncesionet deri sot, siç u theksua pak më parë edhe në fjalën e kryetarit të komisionit, numri total i koncesioneve në vlerë totale korrente është prej 544 miliardë lekësh për 218 kontrata. Kuptohet, është prodhim i një periudhe kohore relativisht të gjatë, rezultuar nga pjesa më e madhe e tyre, gati 60% kontrata të pakërkuara dhe pjesa më e madhe në numër ka ndodhur para vitit 2013. Kjo vlerë, sigurisht, kërkon të analizohet dhe është analizuar nga Ministria e Financave...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të vitit 2013.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – U lutem përfaqësuesve të medias qetësi, se ju bëni punën tuaj, por po flet ministria për Financat dhe Ekonominë!

Ju lutem, qetësi!

Anila Denaj – Për të dhënë një shembull, në qoftë se nga periudha 2004-2013 kemi 176 kontrata aktive, ndërkohë në periudhën 2014-2019 kemi 52 kontrata aktive, këto janë në numër, ndërsa në vlerë, në periudhën 2004-2013, janë 385,5 miliardë lekë, ndërsa në periudhën 2014-2019 janë 421 miliardë lekë. Pra, kuptohet kjo pasqyrë duhet të analizohet jo vetëm sot, por duhej të ishte analizuar çdo vit dhe në vijueshmëri.

Në raport me vlerësimin paraprak, që mund t'i ketë bërë Ministria e Financave dhe Ekonomisë çdo kontrate koncesionare, roli i Ministrisë së Financave deri sot ka qenë kryesisht i parashikuar në ligjin e buxhetit, në atë që revizohej në mënyrë konstante çdo vit buxhetor se sa shkon tavan dhe që ky tavan të mos shkelet sipas parashikimeve ligjore.

Sikurse ju e dini, ky tavan është përcaktuar në 5% dhe ne sot i kemi kontratat aktive në total, po t'i vlerësojmë, në 3%. Mund të them se totalisht, në mbështetje edhe të kolegëve, ky tavan nuk preket.

Ndërkohë, e theksuam pak më parë, projektligji sjell përmirësime të dukshme nga ana ligjore, sidomos për të kufizuar, le të themi, mënyrën e funksionimit dhe të vlerësimit të investimeve në disa sektorë, aty ku edhe eksperiencia është fituar, por, mbi të gjitha, edhe për të vlerësuar njëkohësisht që disa nga projektet, të cilat kërkojnë një analizë më të gjerë fizibiliteti, në kontekst vlere dhe ekspertize, të jenë të hapura për të sjellë ekspertizë nga sektori privat. Kjo do të shkojë paralelisht me një rritje të vlerësimit dhe monitorimit, si përpara dhe pas. Ky projektligj i sjell të dyja këto aspekte në balancë.

Kuptohet, ka situata për të cilat ne, si Ministri e Financave, mund të jemi në kundërshtim edhe me propozimet e sjella nga autoritetet kontraktore, por kjo është diçka për t'u parë, pasi përfshirja e Ministrisë së Financave deri tani ka qenë në analizën paraprake, por jo në momentin e kontratës së firmosur, si dhe pas ka qenë edhe kjo e reduktuar. Pra, roli i Ministrisë së Financave është dukshëm i shtuar për të minimizuar risqet fiskale dhe buxhetore, si dhe për të sjellë edhe kundërshtime aty ku duhet, që të mos merren përsipër vendime të cilat mund të vënë në rrezik çdo element fiskal dhe buxhetor.

Kuptohet që afati 1 korrik ngjalli debat nga disa komisione parlamentare, qoftë edhe në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin u diskutua kjo çështje, ku, së bashku me zëvendësministren e Financave dhe Ekonomisë, e cila solli të njëjtën qasje, edhe unë ndaj të njëjtën qasje, që aktet nënligjore duan kohën e tyre për t'u përgatitur, pra

është e nevojshme një periudhë tremujore. Sa më shpejt t'i kalojmë këto projektligje, aq më mirë ne do të jemi në gjendje t'i sjellim aktet nënligjore në platformat e duhura për zbatim.

Nuk mund të them asgjë për rrugën Tiranë – Durrës, por ndoshta për këtë proces mund të na flasë zonja Alda.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alda Klosi – Në lidhje me...

Arben Ahmetaj – Alda, flitet me leje!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alda Klosi – Në lidhje me koncesionin ose me propozimin për dhënie me koncesion të rrugës Tiranë – Durrës, kjo është kompetencë e Ministrisë së Transporteve, çka do të thotë që, nëse është paraqitur një propozim për dhënie me koncesion, kjo do të vlerësohet nga autoriteti përkatës, që në këtë rast është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila do të kalojë të gjitha fazat që përcakton ligji, si, për shembull, fazën paraprake. Pra, nëse do të vlerësohet se është fizible dhe me leverdishmëri për t'u dhënë me koncesion, atëherë do të fillojmë procedurat e tjera, këto në përputhje me ligjin “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është një vendim, i cili merret nga autoriteti në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore për koncesionet dhe partneritetin publik-privat.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anila Denaj – Ka ende disa pika që po i shikojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe një herë, dua ta theksoj, nuk ka shkuar gabim diçka, është thjesht një përmirësim i dukshëm i gjërave që mësohen gjatë rrugës dhe që duhet të përmirësohen në aspektet ligjore, kryesisht për të përcaktuar një rol të shtuar të Ministrisë së Financave, në mënyrë që projektet, të cilat, sikurse u vendos edhe në perspektivën e viteve ‘35 e përtej, të jenë të parashikuara që tani dhe jo në afatin 30-vjeçar. Në mënyrë absolute ne shikojmë që një garanci për qëndrueshmërinë e këtyre projekteve është analizimi në kohë dhe me përgjegjshmëri nga institucionet përgjegjëse.

Për sa u përket çështjeve të konkurrencës së hapur, heqja e bonusit është një element tejet i rëndësishëm për të rritur konkurrencën edhe në propozimet e pakërkuara, ndërkohë që të gjitha ndryshimet ligjore që vijnë për propozimet e kërkuara, duke e theksuar edhe më parë që këto janë subjekt i ligjit të prokurimit publik, nr. 125, pra parimet janë të hapura dhe...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Platforma e APP-së është më se e përcaktuar, pra është në detaje, kështu që besoj se kjo është më se e konsoliduar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në raport me përputhshmërinë e PPP-së me prioritetet kombëtare dhe si i trajton ligji, besoj se strategjia kombëtare merret parasysh kur flitet për projekte të tilla, sepse janë projekte të cilat, të sjella në nivel ministror, marrin parasysh, në mënyrë të padiskutueshme, edhe qasjen strategjike. Besoj se kjo është një vëmendje jo vetëm nga Ministria e Financave, por nga të gjitha ministratë e linjës.

Lidhur me rekomandimet e marra parasysh nga ndërkombëtarët, besoj se ky ligj është përmirësim si rezultat i rekomandimeve të tyre. Elementi kyç, si heqja e bonusit, është një element tejet i rëndësishëm. Partnerët ndërkombëtarë kanë kërkuar në mënyrë të vazhdueshme përmirësimin e monitorimit dhe besoj se roli i Ministrisë së Financave në këtë projektligj të ri është dukshëm i theksuar në raport me rritjen e monitorimit dhe vendosjen e platformave të diskutimeve për të mbajtur në kufijtë buxhetorë edhe risqet fiskale në limitet e tyre. Kështu, mund të themi se, po, janë marrë parasysh elementet kyçe të rekomandimeve të tyre.

Në lidhje me pyetjen tjetër rreth aspektit ligjor të ministrit të linjës dhe ndryshimit... Unë vij me *background*-in juridik, por në qoftë se këtu ka hapësira për të përmirësuar, prandaj janë diskutimet paraprake për ta përmirësuar. Ne nuk marrim kompetencat e asnjë ministri, por vetëm një rol të shtuar monitorimi, kjo për të realizuar atë që u tha pak më parë, për të ruajtur balancën e aspektit fiskal dhe buxhetor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Ministre!

Tani kam unë një pyetje ose, më mirë, një pyetje me dy nënpyetje.

Së pari, a ka kërkuar ndonjëherë Fondi Monetar Ndërkombëtar që PPP-të të llogariten si borxh?

Së dyti, në *staff report*-in e fundit, a përfshihen PPP-të në borxh?

Së treti, cila është metodologjia që përdoret, nëse doni, në Bashkimin Europian, por ndërkombëtarisht, që kontabilizon PPP-të?

Faleminderit!

Erjon Luçi – Çështja e kontabilizimit të PPP-ve është relativisht e ndryshme edhe midis institucioneve të ndryshme, EUROSTATI ka një metodë të ndryshme nga ajo që përdor

FMN-ja, e bazuar në mënyrën sesi kategorizohen rreziqet për sa u përket rasteve kur garanci të ndryshme fillojnë dhe aktivizohen. Në këtë aspekt, duhet thënë se kërkimi i PPP-ve në bllok, siç diskutohet ndonjëherë, është i pakuptimtë, sepse i bie që të futen të gjitha angazhimet e kredive, të cilat përfshihen në çastin që realizohen.

Për sa i përket realizimit, aty mund të fillojmë një diskutim se sa pjesë e realizuar mund të futet brenda buxhetit, por edhe kjo, në bazë të sistemit që ne jemi angazhuar ta ndërmarrim, do më shumë kohë. Me një llogaritje shumë të thjeshtë, ku ne shpresojmë që në një kohë jo të largët ta bëjmë si vlerësim dhe ta prezantojmë përpara jush, nga totali i PPP-ve aktive ne nuk flasim më shumë se sa 20% e investimeve, jo i korrenteve që janë në buxhet vit për vit. Pjesa më e madhe e PPP-ve, rreth 74 miliardë i këtij totali është i përfshirë vit për vit, ndërsa pjesa tjetër, siç është Rruga e Arbrit, që është një investim madhor, është po ashtu i shpërndarë ndër vite. Kështu që po flasim prapë për një vlerë shumë të vogël të diferencës që mund të ketë edhe zbatimi rigoroz i një standardi që ne për 4-5 vjet do të jemi edhe të gatshëm që ta zbatojmë në praktikë.

Arben Ahmetaj – Pyetja tjetër lidhet me stafraportin dhe rekomandimin, a ka kërkuar Fondi Monetar ndonjëherë me shkrim zyrtarisht dhe a e ka përfshirë në stafreport këtë që ka kërkuar opozita dhe përfshirjen në borxh e të tjerë?

Erjon Luçi – Jo në mënyrë eksplicite të këtij lloji. Në raportin e fundit borxhi është i ngjashëm me borxhin tonë, duke hequr ndryshimin, që e kemi thënë disa herë, të detyrimeve të prapambetura edhe të qeverive lokale, të cilat janë në rënie.

Arben Ahmetaj – Pra, FMN-ja nuk e ka kërkuar këtë gjë, sepse iu referua rekomandimit. Në dijeninë time, të detajuar, zyrtare, FMN-ja ka kërkuar rritjen e rolit të Ministrisë së Financave dhe, së bashku me SIGM-ën e me komisionin edhe heqjen e bonusit. Pra, të dyja rekomandimet e Fondit Monetar janë të reflektuara.

Faleminderit!

Ismet Beqiraj – Kam dy pyetje. Kur diskutohen koncesionet e partneritetit privat publik, një nga shqetësimet që është evidentuar ka qenë edhe kostoja për njësi, sidomos në infrastrukturë. Ky projektligj, gjatë miratimit të projekteve koncesionare, a e ka marrë në konsideratë këtë shqetësim? Cilat çmime merren në referencë, ato të liberalizuara të tregut në Shqipëri dhe jashtë, apo çmimet sipas buletineve zyrtare në treg?

Pyetja e dytë lidhet me një strukturë organizative, që është edhe një shtesë e ligjit aktual në nenet 6 dhe 12/1 për ngritjen dhe funksionimin e komitetit përzgjedhës për projektet e koncesionit. Sot, kur bëhet përzgjedhja e tyre, që janë drejtuesit kryesorë, titullarët e 5

ministrive, dhe komitetit fton rast pas rasti, pa të drejtë vote edhe titullarët e autoriteteve kontraktore. Në kuadër të problemeve që ngriti protesta e studentëve, bota akademike, pedagogët, për gjithëpërfshirjen edhe në projektet strategjike dhe të rëndësishme të zhvillimit të vendit, specialistë dhe autoritetet e botës akademike duhet të bëhen pjesë e saj. Pavarësisht mendimit tim, a mendoni se në këtë projektligj duhet të marrë pjesë edhe bota akademike, qoftë edhe pa të drejtë vote? Sepse në projekte të rëndësishme, siç është ajo e kaskadës së Drinit, ka pasur shkencëtarë, të cilët e nderojnë këtë komb, pedagogë dhe profesorë, të cilët, në një kohë tjetër, kanë qenë pjesë e këtyre projekteve të rëndësishme, duhet të jenë edhe në një partneritet privat publik, që shkon dhjetëra dhe qindra milionë euro?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Po, zonja Ministre!

Anila Denaj – Lidhur me koston për njësi, sigurisht që aplikimi i ligjit për të rritur konkurrueshmërinë midis projekteve është një element që do të ulte koston për njësi dhe ky është një përmirësim i dukshëm i këtij ligji, sidomos në projekte që kanë të bëjnë me infrastrukturën.

Sigurisht, energjia është një fushë shumë e gjerë, ku projektet janë të një rëndësie, jo vetëm të veçantë, por janë projekte të mëdha, ku teknologjia përparon dhe ku një vlerësim i plotë i një *feasibility study* do të kërkonte një ekspertizë të huaj të shtuar, përveç asaj lokale që ne kemi. Besoj se vendosja e mbajtjes së këtyre projekteve brenda të njëjtit format trajtimi, shkon pikërisht në këtë linjë, që t'i japim mundësinë ekspertizës që sjell sektori privat, i cili është më i përditësuar sesa ai publik. Kjo nuk u heq absolutisht vlerën që kanë të gjitha platformat dhe forumet akademike, megjithatë, në raport me komitetin, ai ka anëtarë permanentë, të cilët marrin përgjegjësi ligjore për analizat ekonomike dhe impaktet që ato sjellin. Platforma e përfshirjes së tyre pa të drejtë vote mund të shikohet, por ajo është një platformë, të cilën ne sot, si ministri, e kemi të ushtruar edhe në formate të tjera. Po ju jap një shembull, ku secili nga ministrat ka këshillin e tij strategjik dhe brenda këtij formati mundet që këto marrëdhënie t'i thellojmë më shumë për të marrë benefitin e akademikëve në kontekstin strategjik të komitetit që ajo ministri ka, në rastin konkret Ministria e Energjisë dhe Infrastruktura.

Lidhur me ndikimin që kanë kontratat në rritjen e nivelit të borxhit publik, referuar legjislacionit në fuqi, në fushën e koncesioneve PPP, konkretisht në nenin 8 parashikohet se për klasifikimin e projekteve të koncesionit PPP, brenda bilancit të qeverisë, duhet të respektohen rregullat e sistemit europian të llogarive ESA 95, ku merret në analizë alokimi i

tre risqeve kryesore: risku i ndërtimit, i disponueshmërisë dhe ai i kërkesës. Nëse risku i ndërtimit transferohet tek operatori privat i kombinuar me njërin nga risqet e tjera, automatikisht këto projekte dalin jashtë bilancit të qeverisë. Kjo është edhe arsyeja që të gjitha projektet e ndërtimit, operimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve klasifikohen jashtë bilancit, pasi partneriteti privat ka marrë përsipër riskun e ndërtimit dhe riskun e disponueshmërisë. Kjo ishte shumë e rëndësishme për ta theksuar.

Arben Ahmetaj – Ky rregull nuk ka ndryshuar. Për transparencë ndaj publikut, mënyra e kontabilizimit në bazë të risqeve nuk ka ndryshuar asnjëherë, ka qenë themelore në ligjin e koncesioneve. Nuk ka pasur ndonjë rregull tjetër para vitit 2013 dhe u ndryshua, por ka qenë dhe është i njëjti rregull.

A ka pyetje tjetër?

Po, zonja Dhima.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Ministre!

Unë kam një pyetje. Te neni 6 pas nenit 12 shtohet neni 12/1 me këtë përmbajtje: “Janë disa pika për krijimin e komitetit të përzgjedhjes së projekteve...”

Arben Ahmetaj – Ju kërkoj ndjesë që ju ndërhyj, nën për nen ne do ta vazhdojmë një ditë tjetër. Nëse është ndonjë gjë që është në parim, mund ta thoni me kënaqësi, por nëse është diçka teknike atëherë...

Antoneta Dhima – Dakord, po e bëj pyetjen në përgjithësi. Deri tani si është bërë përzgjedhja e projekteve të koncesioneve dhe PPP-ve dhe kush kanë qenë personat që kanë marrë në shqyrtim dhe kanë miratuar dhënien e tyre?

Arben Ahmetaj – Po.

Alda Klosi – Për sa i përket mënyrës së përzgjedhjes së projekteve, duke pasur parasysh që ligji lejonte propozimet e pakërkuara, normalisht secili nga autoritetet kontraktore ka pasur mundësi që t’i shqyrtonte këto projekte.

Risia që sjell ky projektligj është krijimi i komitetit përzgjedhës së projekteve, i cili për t’i paraprirë ndryshimeve që mund të ketë konfigurimi i qeverisë dhe për t’i dhënë një aspekt sa më afatgjatë këtij ndryshimi, parashikon pesë fusha përgjegjësie, të cilat gjenden të përqendruara në tre. Megjithatë roli dhe funksioni që do të ketë komiteti i përzgjedhjes së projekteve, i cili është një komitet kolegjal, përfshinë ato funksione të qeverisë, të cilat duhet të sigurojnë sinkronizimin me strategjitë e çdo sektori, por edhe në kuptimin e përgjithshëm si nivel qeverie. Ky komitet, do të jetë në gjendje të angazhojë ekspertizë në nivel teknik,

asistuar edhe nëpërmjet agjencisë “ATRAKO”, për të mundësuar një analizë më të thellë përpara vendosjes së përcaktimit të mënyrës sesi do të financohet ose mënyrës sesi një projekt i caktuar do të bëhet me prokurim, me koncesion apo me partneritet publik privat. Për këtë ky komitet do të ketë mundësi që të përzgjedhë ekspertizën e duhur që asiston në këtë fushë. Faleminderit!

Arben Ahmetaj – A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Kalojmë në diskutime. A ka ndonjë diskutim?

Po, zoti Haxhinasto.

Edmond Haxhinasto – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja ministre për shpjegimet!

Në gjykimin tim, ky projektligj sjell vetëm një të re, sjell përqendrimin e kompetencave për dhënien e koncesioneve dhe PPP-ve te Ministria e Financave, duke pasur një përplasje shumë serioze me pikën 4, të nenin 102 të Kushtetutës, i cili thotë: “Ministri drejton nën përgjegjësinë e tij veprimtarinë që ka në kompetencë”, pra kjo kompetencë nuk mund t’i kalojë asnjë ministrie tjetër. E para.

E dyta, zonja Ministre, ju theksuat që Ministria e Financave nuk ka qenë pjesë e vlerësimeve koncesionare, kjo nuk është e vërtetë, sepse është në ligj. Pra për të bërë vlerësimin e çdo propozimi të pakërkuar Ministria e Financave kishte përfaqësuesin e saj dhe kështu është bërë, prandaj kjo është një arsye që nuk ekziston.

Së treti, nga mekanizmi që është propozuar në këtë projektligj nuk më rezulton që është e mundur, që privati të garantojë marrjen e parave me kosto më të ulët sesa i merr sektori publik dhe rrjedhimisht kostoja e investimit do të jetë më e lartë sesa ato që mund të realizohen nga sektori publik.

Projektligji nuk ka garantuar, në formatin që është sot dhe ju nuk dhatë garanci që mund të garantohet në të ardhmen, që projektet që do të realizohen nëpërmjet kontratave koncesionare apo me PPP-të të jenë në përputhje me listën e prioriteteve kombëtare që kemi për infrastrukturën. Edhe vetë fusha që ju përmendni në projektligj lë jashtë shumë nga fusha të tjera që janë prioritete kombëtare të këtij vendi, për sa i takon infrastrukturës dhe shërbimeve.

Do të kontestoj përgjigjen tuaj për sa i takon shqetësimeve dhe rekomandimeve të FMN-së. Zëvendësministri, ishte shumë i sigurtë dhe shumë i saktë në atë që tha. Në raporte të FMN-së mund të mos ketë qenë, por disa herë në deklaratat e delegacionit të FMN-së për Shqipërinë është shprehur qartë që shqetësim përbën rreziku që sjellin koncesionet dhe në

gjykimin e tyre, ata kanë thënë që duhen trajtuar si borxh. Nëse doni unë mund ta gjej deklaratën dhe t'ju vë në dispozicion.

E fundit, pavarësisht se u përmend këtu që propozimi i LSI-së është marrë në konsideratë dhe është tejkaluar, mund t'ju them që as nuk është marrë në konsideratë dhe as nuk është tejkaluar. Thelbi i rekomandimit të LSI-së ka qenë rritja e transparencës dhe në rastet kur periudha e koncesionareve apo të PPP-ve i kalon 4 vjetët të trajtohen nga parlamenti, pra për ato raste kur jetëgjatësia e një koncesioni e kalon mandatin e një maxhorance të caktuar.

Duke pasur parasysh atë çfarë thashë më sipër, unë mendoj që ky ligj të mos kalojë, por të ritrajtohet, duke pasur parasysh përputhshmërinë me Kushtetutën dhe me kompetencat që i Kushtetuta i jep ministrive të ndryshme, duke pasur parasysh nevojën për të gjetur mekanizmin e duhur që paratë të gjenden me kosto shumë më të ulët sesa mund t'i sigurojë privati dhe të gjithë kontratat, projektet, zhvillimi i infrastrukturës dhe i shërbimeve të realizohen në përputhshmëri me listën e detyrueshme që ka Republika e Shqipërisë për të realizuar infrastrukturën sipas procesit të Berlinit dhe në mënyrë më specifike sipas Samitit të Vjenës. Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Po, zoti Angjeli.

Anastas Angjeli – Përsëritet të gjithëve!

Pyetja e parë që duhet të shtrojmë është: a është i domosdoshëm një ligj, i cili bën rregullimet e nevojshme për procesin e partneritetit publik privat dhe përse? Unë besoj se po. Përse besoj se po? Siç e kemi diskutuar dhe u jemi përgjigjur disa herë interesit publik, partneriteti publik privat nuk është një shpikje e shqiptarëve, por është një përvojë e shumë vendeve të tjera europiane. Ajo që është shqiptare është që ne e kemi implementuar këto 10 vjetët e fundit. Nga kjo pikëpamje është një gjë e re e aplikuar në Shqipëri, nga të dyja qeveritë, dhe nuk mund të mos kishte problematikën e vet si çdo gjë e re që është zbatuar në vendin tonë në këto 30 vjet tranzicion, si në aspektin e kuadrit ligjor, ashtu edhe në aspektin e zbatimit konkret të këtij kuadri ligjor. Pra përvoja dhe eksperiencia e fituar në rrugën e zbatimit të kësaj metode, në ekonominë shqiptare, nuk mund të mos nxirrte problematika dhe shqetësime, të cilat duhen rregulluar, prandaj jemi këtu. Por në të njëjtën kohë, jo vetëm përvoja e atyre që i bëjnë dhe i zbatojnë, por edhe reagimet e opinionit publik duhet të reflektohen. Këtu bën pjesë edhe transparenca, sepse me fjalë është, por duhen veprime konkrete.

Pra, kjo është transparencë, që të gjitha problematikat, të cilat konsiderohen thelbësore në një debat publik të zhvilluar për një çështje kaq të rëndësishme, kaq të prekshme, të reflektohen një ditë.

E treta, pa dyshim që në të gjithë veprimtarinë tonë jemi të monitoruar nga institucionet ndërkombëtare, të cilat herë pas here kanë dhënë rekomandimet e tyre dhe ne, në bashkëpunim me to, nuk mund të mos i konsiderojmë rekomandimet e tyre. Pra, këto janë, si të thuash, tre elemente shumë të rëndësishme, që na sjellin në një moment të tillë për të reflektuar mbi një ligj, ashtu sikurse ndryshojnë shumë ligje të tjera.

Pa dashur këtu të them tre elementet thelbësore që sjell ndryshimi i ligjit, si: heqja e propozimit të pakërkuar, heqja e bonusit dhe forcimi i rolit të Ministrisë së Financave, doja të theksoja edhe dy elemente të tjera, që i përmendën edhe parafolësit nëpërmjet pyetjeve të tyre.

Njëra çështje ishte: sa kushtetuese është ose sa ligjor mund të jetë ndryshimi i një neni ose i një çështjeje tjetër? Është e drejtë që të hedhësh një hipotezë lidhur me një nen ose një artikull të veçantë të projektit, por parlamenti nuk vepron apriori, ne nuk e ngremë dorën, sepse e shohim të shkruar këtu. Pra, ne kemi një komision tjetër, që është përgjegjës për të parë edhe kushtetutshmërinë, edhe rregullin e ligjit, siç zonja Dhima donte të pyeste te neni 6, ku, me të drejtë, mund të diskutohet atje për të parë emërtimet dhe përbërjen e komisionit, pra ne kemi Komisionin e Ligjeve, i cili na dërgon me shkrim rekomandimin për ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e ligjit dhe ne do të veprojmë në përputhje me rekomandimin që do të na dërgojë komisioni.

Së dyti, zoti Vulneti ngriti një çështje shumë të rëndësishme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, është Vullneti në fund.

Ajo çështje kishte të bënte me pjesëmarrjen e publikut...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, ndoshta e ngriti si çështje një deputet tjetër!

Pra, ajo çështje kishte të bënte me pjesëmarrjen e publikut, me forcat dhe kapacitetet intelektuale, që pse nuk janë tek ai komision... A ishte kështu, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë besoj se, përveç atij, ka disa elemente të tjera në ligj, siç është ATRAKO, siç janë edhe këshillat e të gjithë ministrave, ku forcat intelektuale për vlerësimin e projektligjeve kanë qenë dhe duhet të jenë medoemos.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk mund të thuash që, shiko, se kemi një komision, një agjenci apo një komitet prej pesë ministrash, ndërkohë që këtu do të vëmë edhe një profesor. Mund ta vëmë, nuk është problem, por në qoftë se ai është në ATRAKO, në qoftë se është në këshill, mendimi i tij është përcjellë, sepse ministrat nuk janë ekspertë që të diskutojnë nga këto pikëpamje, po edhe ata kanë një grup përpara, pas ose rreth tyre që u jep mendimin për këtë çështje.

Së fundi, do t'i rikthehem çështjes dhe debatit, i cili ka marrë shumë vëmendje edhe në opinionin publik, edhe këtu në komision, edhe tek ekspertët, nëse është ose jo borxh, a duhet futur ose jo në borxh. Këtu u tha që, për sa kohë sistemi europian bazohet në një sistem të atillë llogaritjeje, mbi të cilin bazohemi edhe ne për përfshirjen ose jo apo të cilës pjesë në borxhin publik, ne do të jemi konform atij sistemi.

Në dijeninë time, po punohet nga institucionet ndërkombëtare, si: Banka Botërore, IFC-ja, si dhe nga ekspertët e Bashkimit Europian për të pasur një metodologji të saktë, e cila do të dalë ndoshta brenda këtij viti, të cilën po e përqafuan të gjitha shtetet, do ta përqafojmë edhe ne, pa merak fare, siç kemi bërë deri tani. Kjo nuk është një metodë që përdoret sot dhe vetëm nga ne, por për sa kohë që këto institucione, ku njëri e ka një metodologji, ndërsa të tjerët jo dhe janë duke bërë një të tillë, kjo do t'i përfshijë të gjitha vendet, pra do t'i nënshtrohet pa dyshim, siç kemi edhe bërë deri sot, edhe vendi ynë.

Në këtë kuptim, dua të them që edhe me rekomandimin e Komisionit të Ligjeve, në parim, ne bëjmë një hap pozitiv reflektues në rregullimin e këtij projektligji, por edhe të të gjithë procesit, i cili, natyrisht, ka pasur debatin e tij. Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Angjeli!

Para se t'ia jap fjalën zotit Bushati, dua të bëj disa komente.

E para, nëse në të njëjtën kohë do t'i referoheshim edhe kërkesës së zotit Vasili, të cilën e kam përpara, edhe ai ka kërkuar rritjen e rolit të Ministrisë së Financave.

Në fakt, referenca e nenit është e saktë, sepse Ministria e Financave bën detyrën që ka, nuk do të bëjë infrastrukturë. Edhe në bazë të këtij ligji, mjafton ta lexosh, të marrësh mundimin ta lexosh për dy minuta, Ministria e Financave do të kujdeset për risqet fiskale dhe risqet e mundshme kontingjente në të ardhmen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E dyta, që është shumë e rëndësishme, i gjithë debati: është ose jo borxh, është artificial, sepse neni 8 i ligjit është i drejtpërdrejtë, i referohet metodologjisë dhe risqeve. Pra, metodologjia zbret në detajet e risqeve. Siç ndahen risqet, ashtu kontabilizohet edhe

përgjegjësia, pra borxhi. Aty ku risqet i ka buxheti i shtetit, diskutimi është ndryshe; aty ku risqet i ka privati, diskutimi është ndryshe.

Më vjen keq që zoti Haxhinasto u largua, por unë i kërkoj që t'i mbështesë ndryshimet ligjore, pasi janë një hap më tej në rregullimin e të gjithë procesit, madje ajo që tha, a janë ose jo projektet e mundshme të PPP-së (qoftë si pyetje, qoftë koment) brenda listës së prioritetëve kombëtare, patjetër që janë të gjitha.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rruga e Arbrit është pjesë e rëndësishme e prioritetëve kombëtare; e gjithë linja adriatiko-joniane, që praktikisht kalon nëpërmjet segmentit Milot – Balldren, është pjesë e projekteve, madje kombinimi ndërmjet projekteve publike dhe koncesioneve ose PPP-ve, sigurisht që kalon në një filtrim të prioritetëve strategjike nga Këshilli i Ministrave. Besoj se këto janë të qarta edhe te ndryshimet ligjore. Gjithsesi, e ftoj zotin Bushati të japë komentet e tij.

Ervin Bushati – Faleminderit!

Në fakt, siç e përmendi edhe zoti Haxhinasto, raporti i FMN-së, datë 20.11.2018, adreson dhe është në sinkron me ndryshimet e sjella nga qeveria, kur thotë që niveli i PPP-ve në ekonomi është 31% në raport me GDP-në, ku 23% janë në energji. Pra, tre të katërtat e të gjitha PPP-ve ose, më saktë, 74,2% e të gjitha PPP-ve në vlerë monetare janë dhënë në energji para vitit 2013, pika e parë.

Gjithashtu, FMN-ja adreson faktin që tavanin për PPP-të, për pagesat, është nën 5% të ardhurave vjetore, që mbahen në buxhetin e shtetit. Kjo adreson...

(Kryetari i komisionit ndërhyr pa mikrofon.)

Po pra, është në projektbuxhetin e vitit 2019, të certifikuar nga FMN-ja. Të dyja këto janë shumë të qarta: a) tre të katërtat e të gjitha PPP-ve janë dhënë në qeverisjen para vitit 2013, dhe b) jemi ende larg tavanit.

Gjithashtu, thuhet se duhet të adresohen të gjitha përmasat dhe efektet për të cilat po flasim sot, ku Ministria e Financave të ketë një rol më parësor, të jenë të kontrolluara, të hiqet bonusi e të tjerë.

Për sa i përket borxhit, kjo është më se e qartë, përderisa Banka Botërore, FMN-ja dhe të gjitha institucionet ndërkombëtare nuk e llogarisin. Kjo është alfa e kontabilitetit! Për sa kohë këto investime nuk janë në buxhetin e shtetit, pra është bazë e pasqyrave të kontabilitetit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse me këtë logjikë, po ashtu, edhe borxhi privat ose NPL-të pastaj, si dhe çdo investim që bëhet, duhet të futej dhe të mbahej nga shteti. Në shtetin socialist ose komunist, ku gjithçka që investohet nga privatët, nuk mbahet në kontabilitetin e shtetit. Në të kundërt, edhe pensionet do të quheshin borxh apo çdolloj skeme tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Diskutimi nëse janë ose jo borxh i fshehur, duhet të mbyllet njëherë e mirë, sepse në këtë logjikë çdo gjë tjetër pastaj mund të quhet borxh.

Për sa kohë kontabilizohen kështu dhe jemi ende në kapitalizëm, kështu do të mbahen. Në qoftë se këta duan të kalojnë në një sistem tjetër, ku çdo gjë e matin dhe e quajnë borxh, ai është koncept krejt tjetër, që nuk ka të bëjë me këtë lloj ekonomie. Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Në qoftë se nuk ka diskutim tjetër nga kolegët, unë mendoj ta hedhim në votim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në parim.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim projektligji.

Faleminderit, zonja Ministre!

Faleminderit edhe stafit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të shihemi javën tjetër për diskutimin nen për nen të projektligjit, ndoshta të hënën ose të martën, por do t'ju lajmërojmë paraprakisht.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti

